

SPECIFIKIME TEKNIKE

.

SPECIFIKIMI I ÇMIMEVE

OBJEKTI: REHABILITIM SHKOLLA SOVJAN

Punimet e gërmimit dhe transportit

Ky zë përfshin përcaktimet e përgjithshme dhe kërkesat për punimet e gërmimeve në tokë (në vëllim dhe/ose me shtresa) dhe gërmimet për struktura të vogla dhe në kanale, përfshirë gërmim nën ujë. Këto zëra punimesh mbulojnë të gjitha punimet që lidhen me realizimin e seksioneve sipas detajit tip dhe largimin e materialeve të papërshtatshme deri në pikën e depozitimit të tyre. Gërmimi në dhera duhet të aplikohet në të gjitha materialet që mund të gërmohen si me krahë, (përfshi me kazma) ashtu dhe me makineri.

Punimet e gërmimit do të fillojnë pasi të jetë bërë piketimi në përputhje me planet e gërmimeve si dhe pasi të bëhet azhurnimi dhe verifikimi i sistemeve ekzistuese nëntokësore. Për gërmimin do të përdoren makineri të përshtatshme (eskavatorë të llojeve të ndryshme) bazuar në seksionin e parashikuar në profilin tip të mënyrës së ndërhyrjes.

Materiali i dalë nga gërmimet, i cili nuk do të përdoret si material mbushës do të depozitohet në vendet e miratuara nga Autoritetet përkatëse. Transporti duhet të bëhet me kamionet përkatës vetëshkarkues (me kapacitete të ndryshme). Materialet e përshtatshme do të përfshijnë të gjitha materialet që janë të pranueshme në përputhje me specifikimet teknike për të formuar mbushje të qëndrueshme ose trase.

Pas kryerjes së gërmimit deri në kuotën e parashikuar në projekt dhe të instruktuar në terren nga mbikqyrësi i punimeve, duhet të bëhet ngjeshja me rul vibrues (dinamik). Ngjeshja e tabanit duhet të jetë një minimum dendësie të thatë prej 95% për dhera të shkrifët dhe 90% për dhera të lidhur.

Makineritë për gërmimin dhe transportin e materialit të dalë nga gërmimi do të përdoren vetëm nga personel i specializuar dhe i pajisur me lejet përkatëse të drejtimit.

Ndertim mur buto betoni

Ne kete çmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m3 mur butobeton ku beton C16/20 + 25% gur kave per ndertimin e themelit te mureve anesore, sipas detajit teknik me gjeresi dhe lartesi sipas projektit. Ne cmim futet teresia e shpenzimeve per blerjen e materialeve rere guri, cemento, gur kave, transportin. Betoni te prodhohet me betoniere ne objekt sipas kushteve teknike dhe standartet, te realizohet marka e kerkuar e betonit.

Shtrese zhavori t = 10cm

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m2 shtrese zhavori me trashesi shtrese 1X10 cm pas ngjeshjes me tokmak, duke patur parasysh kuotat e trotuarit, ne cmim futet teresia e shpenzimeve per blerjen e materialit,

transportin shperndarjen e tij ne trotuar dhe ngjeshjen e tij me tokmak sipas kushteve teknike .. Ne cmim futet dhe testet e bera per standartin e cakellit.

Trotuar ,me 6cm beton, me pllaka.

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m2 shtrese pllake ne trotuar mbi shtrese betoni pas berjes se shtreses zhavorit duke patur parasysh kuotat e trotuarit. Ne cmim futet teresia e shpenzimeve per blerjen e pllakave parafabrikat betoni $t = 6\text{cm}$, transportin shperndarjen e tyre,si dhe vendosja e tyre dhe mbushjen e fugave me rere. Pllakat duhet te jene te shoqeruar me certifikaten e cilesise. Per lloin e pllakave te meret miratimi nga Investitori.

Beton C – 16 /20

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m3 beton C – 16 / 20 per ndertimin e shtreses se betonit poshte bordurave,pllakave rreth pallateve me gjeresi dhe lartesi sipas faktit, ne cmim futet teresia e shpenzimeve per prodhimin ose blerjen e materialeve inerte , cimento, transportin , pergatitjen e armaturave me derrese te stazhionuar ose metalike ,pergatitjen e betonit dhe hedhjen ne veper , ngjeshjen me vibrator , dhe trajtimin me uje per realizimin e markes te kerkuar dhe dizarmimin e armatures . Ne cmim futet dhe testet e bera per marken e betonit. Betoni te merret l gatshem nga nje nyje e mekanizuar ose te prodhohet me betoniere ne objekt sipas kushteve teknike dhe standartet, me rere guri + cakell, te realizohet marka e kerkuar e betonit

Shtrese me pllaka pllaka granili

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m2 shtrese pllaka granili 40x40 cm rreth pallateve mbi shtresen e betonit te hedhur me pare $t=10\text{cm}$ c16/20. Ne cmim futet teresia e shpenzimeve per blerjen e pllakave prej granilit e zakonshme, transportin shperndarjen e tyre,si dhe vendosja e tyre me lac. Pllakat duhet te jene te shoqeruar me certifikaten e cilesise.

F.V. Bordura parafabrikat betoni C – 16 /20 .

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 ml bordure ne rruge dhe trotuar. Ne cmim futet teresia e shpenzimeve per blerjen e bordureve parafabrikat betoni, transportin shperndarjen e tyre,si dhe vendosja e tyre me topograf. Fiksimi l bordurave do te behet ne beton C – 16 / 20. Bordurat duhet te jene te shoqeruar me certifikaten e cilesise.

Rrethimi me mur dhe kangjella

Muri me beton

Gërmime seksion të caktuar për themele deri në thellësinë 50 cm nga rrafshi i tokës, në terren të çfarëdolloj natyre dhe konsistence, të lagur ose të thatë duke përfshirë prerjen dhe heqjen e rrënjëve, trungjeve, gurëve dhe pjesëve me volum deri në $0,3\text{ m}^3$, plotësimin etj. Përforcimin e çfarëdolloj marke dhe rezistence, mbushjen e pjesëve të mbetura bosh pas realizimit të themeleve, me materialin e gërmimit me dore, duke përfshirë zhvendosjen brenda ambientit të kantierit.

Muri i themeleve do të realizohet me butobeton duke përfshirë çdo mjeshtëri për dhëmbët e lidhjes si dhe çdo gjë tjetër të nevojshme për mbarimin e muraturës dhe realizimin e saj më së miri.

Xokolatura duhet të behët me mur betoni në lartësi deri 60 cm prej sipërfaqes të dheut ose rrugës.

Kolonat:

Në distancën maksimale deri 2.5 m duhet të vendosen kolona prej metali në dimensionet sipas projektit.. Ata duhet në majë të mbulohen duke salduar pllaka metalike me dimensionet e njëjta si kolonat. Kolonat duhet ancoruar mirë në murin e ndërtuar më parë.

Kangjellat:

Kangjellat duhet të jenë të bëra prej metali dhe të saldohen/ngjiten mirë me kolonat. Ata duhet të lyhen të paktën dy herë me bojë kundër korrosionit. Format dhe pamja e kangjellave do të vendoset së bashku me arkitektin/inxhinierin .

Hapësirat e kangjellave nuk duhet të jenë më shumë se 12 cm, që të mos mundet të kalojë njeri ndërmjet atyre.

Lartësia minimale e gardhit duhet të jetë 2.0 m. (muri +kangjellat).sipas projektit

Dera metalike

Duhet të vendosen dy dyer ose porta të jashtme metalike. Njëra duhet të plotësojë kërkesat e kalimit të makinave, kurse tjetra duhet të plotësojë kërkesat e kalimit të njerëzve.

Dera e jashtme mundet të bëhet në këtë mënyrë:

Furnizim dhe vendosje e nje porte metalike rrëshqitëse, që hapet me dorë, e instaluar në hyrjen kryesore, e formuar nga një kasë kryesore me profil metalik psh 50 x 50 mm të mbështetur në fund me profil 200 x 50 mm.

Kasa e dytë do të përbëhet nga hekur me diametër 16 mm, të vendosur dhe të salduar siç tregohet në projekt. Në pjesën më të ulët të kasës kryesore metalike do të instalohen min. 2 rrota metalike për rrëshqitjen e portës me profil në formë L të fiksuar në të njëjtën bazë betoni, në të cilën janë fiksuar 2 kolonat e hekurit që mbajnë të gjithë strukturën e portës rrëshqitëse.

Baza e betonit, në të cilën do të vendoset porta, varet nga pesha e asaj, por duhet më së pakti të ketë këto dimensione: një thellësi prej min. 40 cm dhe një gjerësi prej min. 40 cm. Inxhinieri do të vendosë për dimensionet e themelit varësisht nga dimensionet e derës dhe peshës që ai do të mbajë.

Porta do të pajiset me bravë sigurie me çelësa në tre kopje, dorezë hekuri dhe me të gjithë pjesët e tjera speciale për mbylljen e portës si dhe aksesore të tjerë, si dhe çdo gjë tjetër për ta konsideruar portën të përfunduar dhe funksionuese më së miri.

Punime te ndryshme ne prishje

Puna për prishje do të fillojë vetëm pasi të jenë stakuar energjia elektrike dhe rrjete të tjera të instalimeve ekzistuese të objektit.

Metodat e prishjes së pjesëshme, duhet të jenë të tilla që pjesa e strukturës që ka mbetur të sigurojë qëndrueshmërinë e ndërtesës dhe të pjesëve që mbeten.

Kur prishja e ndërtesës ose e elementeve të saj nuk mund të bëhet pa probleme e ndarë nga pjesa e strukturës do të përdoret një metodë pune e përshtatshme. Elementë çeliku

dhe struktura betoni të forcuar do të ulen në tokë ose do të prihen për së gjati sipas gjerësisë dhe përmasave në mënyrë që të mos bien. Elementët e drurit mund të hidhen nga lart, vetëm kur ato nuk paraqesin rrezik për pjesën tjetër të stukturës. Kur prishen elementët, duhen marrë masa për të mos rrezikuar elementët e tjerë konstruktive mbajtës, si dhe mos dëmtohen elementët e tjerë.

Në përgjithësi, puna e prishjes duhet të fillojë duke hequr sa më shumë ngarkesa të panevojshme, pa ndërhyrë në elementët bazë struktural. Punë të kujdesshme do të bëhen për të hequr ngarkesat kryesore nën kushtet më të vështira.

Siguria në punë

Kontraktori duhet të sigurohet se vendi dhe pajisjet janë :

- a) Të një tipi dhe standarti të përshtatshëm duke iu referuar vendit dhe llojit të punës që do të kryhet
- b) Të siguruar nga një teknik kompetent dhe me ekperience

c) Të ruajtura në kushte të mira pune gjatë përdorimit

Gjatë punës prishëse të gjithë punëtorët duhet të vishen me veshje të përshtatshme mbrojtëse ose mjete mbrojtëse si: helmata, syze, mbrojtëse, mbrojtëse veshësh dhe bombola frymëmarrjeje.

Prishja e çatisë

Shpërbërja e mbulesës së çatisë me tjegulla dhe të armaturës përkatëse prej druri, duke përfshirë trarët e mundshëm, dyshemenë ose paretet (ndërmjetëzat) me dërrasa, armaturën e madhe (e përbërë nga kapriatat, Trarët dhe pjesët e armaturës), pjesët intersektuese, kanalet e ulluqëve horizontale, ulluqët vertikale dhe kapset përkatëse metalike që rezultojnë nga heqja brenda ambientit të kantierit, si dhe zgjedhjen, pastrimin si dhe çdo detyrim tjetër për t'i dhënë fund heqjes.

Ndertimi I çatisë

Ndertimi I çatisë e matur horizontalisht do të realizohet me lende druri të sharuar e mbeshtetur mbi trare të sharuar dhe të stazhionuar.

Lenda e drurit do të jetë e stazhionuar në mënyrë natyrale ose artificiale, inprejuar me vaj të djegur të përshtatshëm për lenden e drurit .

Makazet e çatisë do të jenë 5x3 në çdo 33 cm

Permasat e mahive 10x6 cm largësia e tyre çdo 60 cm

Tjegullat do të jenë të reja betonike importi cilësi e pare, të gozhdura ose të lidhura duke përfshirë lidhjen e ulluqëve horizontale të çatisë dhe kulmeve duke përdorur llac bastard M-25 të xingato , skelari ose çdo ndryshim tjetër të nevojshëm për ta përfunduar punën. Në drejtim gjatësor do të vendosen kontroventime me permasa 10x6 cm.

Dalje në çati

Daljet në çati duhet të planifikohen për këto raste:

- Dalje për pastrimin e oxhakëve
- Dalje për heqjen e borës në raste se ajo e rëndon për së tepërmi çatinë dhe e rrezikon mbajtshmërinë e saj.
- Dalje për të bërë ndonjë riparim në çati.

Për objekte me çati duhet paraparë / planifikuar një dalje e sigurtë prej nënçatisë. Kjo dalje duhet të realizohet me anë të një dritareje me përmasa 60 cm x 80 cm, e cila duhet të lidhet mirë me mbulesën e çatisë në mënyrë që të mos kemi rrjedhje të ujit.

Dalja në taracë ose në nënçati duhet të ketë dimensionin: max. 80 x 120 cm.

Me rëndësi është që kapaku i daljes në çati t'i plotësojë kërkesat e mbrojtjes kundër zjarrit si dhe kërkesat e koeficientit të ruajtjes të ngrohjes të tij

Ulluke horizontale

Realizohen me pjerësi prej 1% per largimin e ujrave .Ulluqet horizontale prodhohen me llamarine xingato me ngjyre me trashësi $t=5$ mm, i formuar nga pjesë të modeluara me mbivendosje minimale 5cm , të salduara në mënyrë të rregullt me kallaj , me bord të jashtëm 2 cm me të ulët se bordi i brendshëm të kompletuara me pjesë speciale në grykën e hyrjes . Ulluku horizontal i modeluar sipas udhëzimeve në projekt , duhet të jetë i lidhur me tel xingato me hallka të forta të vena maksimumi në 70 cm .

Ulluke vertikale

Ulluket vertikale për shkarkimin e ujrave të catise të përgatiten me llamarine prej çeliku e xinguara me ngjyre , duhet të kenë trashësi $t=5$ mm dhe diametër 10 cm dhe të mbulojnë një sipërfaqe nga 30_60 m².

Në çdo ulluk duhet të mbliidhen ujrat e një sipërfaqe catie ose tarrace jo më të mëdha se 60 m². Ulluket duhet të vendosen në pjesën e jashtëme të ndërtesës me anë të qaforeve perkatese prej çeliku të xinguara , të fiksuara çdo 2 m .Pjesa fundore e ulluqeve , për lartësi 2 m duhet të jetë PVC dhe të mberthyer fort me ganxha hekuri si dhe poshtë duhet të kthehen 90 grade.

PREVENTIVUESI

Ing.

Ing.

Ing,